

Burrat dhe Gratë në Shqipëri

Tiranë, më 30 Qershor 2020: “Burrat dhe Gratë” është një publikim vjetor që paraqet të dhëna të ndara sipas gjinisë në fusha të ndryshme të jetës si popullsia, shëndetësia, arsimi, tregu i punës, vendimmarrja etj. Publikimi pasqyron edhe ndryshimet kryesore ndër vite të legjislacionit në fushën e barazisë gjinore. Risi në publikimin e këtij viti janë 2 kapituj të rinj, treguesit sipas gjinisë nga anketat sociale në familje dhe treguesit mbi të drejtat e njeriut. Publikimi mbyllet me Indeksën e Pabarazisë Gjinore dhe Setin Minimal të Treguesve Gjinorë.

Gjetjet kryesore që botimi evidenton janë:

- Lëvizjet e brendshme, gjatë vitit 2019 tregojnë një rritje të ndjeshme të migrantëve burra me 55,2 % dhe migrantëve gra me 13,5 %, krahasuar me vitin 2018.
- Norma e martesave të grave ndër vite tregon një rënie të martesave deri në moshën 24 vjeç dhe rritje të moshës mesatare në martesë. Krahasuar me 5 vite më parë, gratë martohen relativisht 1,6 vite më të mëdha.
- Raporti i abortit është përmirësuar krahasuar me vitin 2018, nga 191 aborte në 181 për çdo 1.000 lindje.
- Për moshat teke 15 deri në 19 vjeç, për çdo 1.000 lindje raporti i abortit ka rënë me rritjen e moshës, ndryshe nga viti i kaluar.
- Mosha mesatare e daljes në pension, në vitin 2019 është 65,1 për burrat dhe 61,0 për gratë, ndërsa për nënat me shumë fëmijë është 55,8 vjeç.
- Në strukturën e policisë, numri i punonjëseve gra rriten me uljen e nivelit të gradave. Për gradën Inspektor përqindja e grave është më e lartë (43,7 %).
- Gratë, gjatë vitit 2019 kanë kryer më shumë blerje online për veshje/pajisje sportive, në krahasim me burrat (56,9 % për gratë dhe 43,1 % për burra).
- Burrat kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtave të personave të privuar nga liria (28,3 %) dhe e drejta e pronës (17,4 %).
- Gratë kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtës për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror (ndihma ekonomike) (25,4 %), e drejta për një proces të rregullt ligjor (14,8 %).
- Për grupin e konsumit “Ushqimet dhe pijet jo-alkoolike”, gratë kryefamiljare shpenzojnë 47,0 % dhe burrat kryefamiljar 43,6 % të buxhetit të tyre.

Linku i publikimit: http://www.instat.gov.al/media/7270/_burra-the-gra-2020_.pdf